

'Bajrami i Fitrit' apo 'Fitër Bajrami'

Krijuar: Marte, 21 Gusht 2012 13:02



Ilmi Rexhepi

Sipas rregullave drejtshkrimore të normëzuara më 1972, vetëm emrave të disa festave u duhet shkruar me të madhe nistorja „si : Viti i Ri, Një Maji, Dita e Pavarësisë, por jo dhe emrave të festave që binin ndesh me ideologjinë komuniste, kuptohet, pashkët dhe bajrami bëjnë pjesë te këto të fundit.

Tashmë është koha që Këshilli Ndërkademi, ndër rishikimet e shumta, të rishohë edhe këtë çështje brenda një kapitulli të tërë rishikimesh që mund të quhej si kapitulli i rishikimeve pastruese nga ngarkesat ideologjike të asaj kohe.

Por, në të njëjtën kohë, ne myslimanët shqiptarë bëjnë mirë që festën e sotit ta quajmë sipas natyrës së sintaksës shqipe (s'ka gjë keq pse fjalët janë me prejardhje të huaj): "Bajrami i Fitrit", dhe jo sipas natyrës së një gjuhe të huaj, aftësia shprehëse e së cilës është mëkat të krahasohet me të

gjuhës sonë: "Fitër Bajrami".

Shqipja ka huazuar e huazon fjalë nga gjuhët e tjera dhe kjo përbën pasuri dhe pasurim të saj, por në sintaksë ka kështjellat. Shkencëtarët bëjnë çudi për paprekshmërinë e saj në rrethana të së kaluares, në të duket dhe dokumentohet më së qarti njësia jonë shqiptare, me të më shumë se me çdo

gjuhë tjetër na ka nderuar dhe na ka ngritur Zoti mbi kombet me të cilat kemi pasur kontakte gjuhësore.

'Bajrami i Fitrit' apo 'Fitër Bajrami'

Krijuar: Marte, 21 Gusht 2012 13:02

Fatmirësisht emri i kësaj feste në gjuhën e Kuranit është si në shqip "iiduffitri-Festa e Fitrit".

Të ruajmë dhe të nderojmë veçantitë natyrore të gjuhës sonë që na e fali Allahu! Quhet kjo punë si mirënjohje ndaj Allahut për begatitë e Tij, si njohje e urtësisë së Tij që fali shumë gjuhë dhe që nuk urdhëroi njësimin e tyre dhe që urren shtytirimin njerëzor.